



Pranuar / Dorezuar Priljena/Pridato Received/Delivary	14.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	8062/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1170/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1170/2021 të datës 16.12.2021 të parashtruar nga ankuesi [] dhe bashkuar sipas Vendimit të Këshillit VK.Nr.15/2022 të datës 28.01.2022, kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1170/2021 e datës 16.12.2021 e parashtruar nga ankuesit []

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr. Ref. BD-153/9 i datës 29.10.2021 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesit,

ë

punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (me tutje referuar si AKP) kanë parashtruar ankesë kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes të cilit vendim është miratuar Rregullorja Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të

nëpunësve të Agjencisë, me pretendimin ankimor se ulja e pagës në masën prej 30% sipas këtij vendimi është në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë, Ligjin e Pagave të Nëpunësve Civilë dhe vetë kontratën e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesve bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë, në mbështetje të nenit 13 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.01.2022 ka nxjerr Vendimin VK.Nr.15/2022 për bashkimin e lëndëve, ku ankesat e ankuesve janë bashkuar në ankesën me numër A.nr.1170/2021 e datës 16.12.2021 të parashtruar nga ankuesi Millosh Vujoviç.

Rrjedhimisht, pas marrjes se informatave nga organi përkatës i punësimit se për çështjen e njëjtë për të cilën ankuesit kanë parashtruar ankesë ka vendosur Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e nenit 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka nxjerr vendim për pezullimin e kësaj procedure ankimore, derisa çështja është vendosur me Aktvendim AC-1-22-0067 nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku si rrjedhojë është ndryshuar Aktgjykimi C-IV-21-0231 i datës 01.02.2022 i shkalles së parë dhe padia e paditësve është hedhur poshtë si e papranueshme për shkak të jo kompetencës lëndore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas plotësimit të kushteve ligjore për trajtimin e kësaj çështje ankimore aktivizoi lëndën, dhe se për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër A.nr.1170/2021 të ankuesit [] ankesën me numër A.nr.1021/201 të ankuesit [] kesën me numër A.nr.1030/2021 të ankuesit [], ankesën me numër A.nr.1034/2021 të ankueses [], ankesën me numër A.nr.1043/2021 të ankueses [] ankesën me numër A.nr.1048/2021 të ankuesit [], ankesën me numër A.nr.1076/2021 të ankuesit [] ankueses me numër A.nr.1134/2021 të ankuesit [], ankesën me numër A.nr.1139/2021 të ankuesi [], ankesën me numër A.nr.1152/2021 të ankuesit [] i; Emailin e datës 09.10.2021 të NJMB për ankuesit; Akt Emërimet/Kontratat e ankuesve; Vendimin VK.Nr.03/2022 të datës 21.01.2022 për vazhdimin e afatit për vendosje; Vendimin VK.Nr.06/2022 të datës 24.01.2022 për bashkimin e lëndëve; Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO219/19 të datës 30.06.2020; Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës; Aktvendim AC-1-22-0067 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës; Emailin e datës 11.11.2021 nga PAK INFO për stafin e AKP-së; Vendimin me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.20021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Rregulloren Nr.2/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë të datës 29.10.2021;

Listën e strukturës së re të pagave; Kërkesën për përgjigje në ankesë, dhe përgjigjen në ankesë; Emailin e datës 12.11.2022; Strategjinë Përmbyllëse të Agjencisë janar 2022 - dhjetor 2024; Listën e deklaratimit të statusit të zyrtarëve publikë në AKP; Rregulloren për Paga të Nëpunësve të AKP-së dhjetor 2017; Vendimin Nr. Ref.BD-120/7 i datës 31.07.2019 i Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Vendimin Nr. Ref.BD-152/3 i datës 07.10.2021 i Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas administrimit të provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesve, *është e pabazuar sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Bordi i Drejtorëve të AKP-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.10.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.Ref.BD-153/9 përmes të cilit ka aprovuar Rregulloren Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, ndërsa ankuesit, përmes emailit zyrtar, me datë 11.11.2021 janë njoftuar me vendimin e bordit menaxhues dhe rrjedhimisht me datë 12.11.2021 janë njoftuar në mënyrë individuale se paga e tyre do të ulët në masën prej 30% nga data 01.04.2022.

Kundër Vendimit Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, ankuesit brenda afatit ligjor kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi me Nr.Ref.BD-153/9 i datës 29.10.2021 për miratimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, përmes të cilës parashihet ulja e pagës në masën prej 30%, është në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë, Ligjin e Pagave të Nëpunësve Civilë dhe vetë kontratën e punës. Rrjedhimisht ankuesit kërkojnë që të aprovohet ankesa e tyre si e bazuar dhe të anulohet Vendimi me Nr.Ref.BD-153/9 i datës 29.10.2021 i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe njoftimi individual për uljen e pagës në masën prej 30%.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se Vendimi me Nr.Ref.BD-153/9 i datës 29.10.2021 për miratimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, përmes të cilës parashihet ulja e pagës në masën prej 30% për ankuesit është mbështetur në dispozitat e nenit 11.6 dhe 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-023, Ligjin Nr.05/L-080, dhe Ligjin Nr.04/L-115), ndërsa si arsyeje e nxjerrjes se këtij vendimi Bordi Menaxhues thekson faktin se në tri vitet e fundit ka pasur vështirësi të theksuara financiare për financimin e aktiviteteve të Agjencisë, ku për vitin fiskal 2020 dhe 2021 financimi në tersi ishte bërë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, e jo tarifa administrative. Në arsyetim të vendimit, po ashtu theksohet analiza krahasuese të cilën e kishte bërë Bordi Menaxhues lidhur me pagën mesatare në vend, duke krahasuar pagën mesatare në Agjenci, me ato të sektorëve dhe aktiviteteve ekonomik në sektorin publikë, ndërmarrjet publike dhe sektorin privat, ku edhe kishte nxjerrë si konstatim se paga mesatare në Agjenci është për 3.24 herë ma e madhe se paga mesatare në Kosovë, përkatësisht 2.5 herë me e lartë se pagat në sektorin publik dhe 2 herë me e lartë se në kompanitë publike.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve analizoj dispozitat e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në të cilat dispozita është mbështetur vendimi i kontestuar, përkatësisht nenit 15 paragrafi 1 nën paragrafi 2.1 ku përcaktohet se: *“Vendimet e poshtëshënuara të Bordit do të merren me shumicën e kualifikuar dhe nuk mund t’i delegohen asnjë personi: miratimi i aktit të themelimit, rregulloreve, strukturës së përgjithshme organizative, politikës financiare dhe të auditimit, shpërblimit, politikës së personelit dhe punësimit të Agjencisë”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me miratimin e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përgjegjësinë e përcaktimit të politikave të agjencisë duke përfshi edhe politikat financiare dhe politikat e personelit të agjencisë i ka bartur të Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Po ashtu, me dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-023, Ligjin Nr.05/L-080, dhe Ligjin Nr.04/L-115), përkatësisht nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: 1. Agjencia financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (“LMFPP”) të zbatueshme për agjencitë e pavarura; 2. Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka autorizime ligjore që të nxjerr rregullore të brendshme, dhe të përcaktojë politikat financiare të agjencisë, duke përfshi edhe politikat e personelit dhe të punësimit. Rrjedhimisht, sipas këtyre dispozitave ligjore, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje konsiderohet si tarifë administrative e Agjencisë dhe përdorët për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka përcaktuar sistemin dhe strukturën e pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, dhe rrjedhimisht me nenin 2 të këtij ligji është përcaktuar se: *Mjetet financiare për pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës*. Mirëpo Ligji Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 21.09.2011, ka hyrë në fuqi pas ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe i njëjti me nenin 21 paragrafi 2 ka përcaktuar se pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje konsiderohet si tarifë administrative e Agjencisë dhe përdorët për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative, dhe mbi këtë bazë ligjore pagat e nëpunësve civil të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kanë qenë me të larta se pagat e nëpunësve civil të sektorit publikë në Republikën e Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh se Agjencia Kosovare e Privatizimit, bazuar në nenin 21 paragrafi 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-023, Ligjin Nr.05/L-080, dhe Ligjin Nr.04/L-115), ka menaxhuar në mënyrë të pavarur me tarifën administrative të Agjencisë, duke përcaktuar edhe sistemin e pagave të nëpunësve civil të ndryshëm nga sistemi i pagave të përcaktuar me Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se Vendimi me Nr.Ref.BD-153/9 i datës 29.10.2021 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Ligjin për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve në këtë kuptim është i pa bazuar.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi me Nr.Ref.BD-153/9 i datës 29.10.2021 është nxjerr në pajtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 nën paragrafi 2.1 ndërlidhur me nenin 21 paragrafi 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-023, Ligjin Nr.05/L-080, dhe Ligjin Nr.04/L-115), sepse sipas shkresave të lëndës, respektivisht vendimit të kontestuar arsyet të cilat kanë sjellë deri të ky vendim kanë qenë vështirësitë financiare, për faktin se buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në vitin fiskal 2020 dhe 2021 është financuar vetëm nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, dhe jo nga tarifa administrative siç përcaktohet me nenin 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe kjo si pasoje e mungesës së shitjes apo aktiviteteve të tjera nga procesi i transferimit të pronës shtetërore. Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për shkak të vështirësive financiare, para nxjerrjes se vendimit të kontestuar, ka bërë analizë krahasuese lidhur me pagën mesatare në Agjenci, me ato të sektorit publikë, ndërmarrjet publike dhe sektorin privat, dhe ka konstatuar se paga mesatare në Agjenci është për 3.24 herë ma e madhe se paga mesatare në Kosovë, përkatësisht 2.5 herë me e lartë se pagat në sektorin publik dhe 2 herë me e lartë se në kompanitë publike, dhe nga pamundësia e sigurimit të buxhetit financiar pesë perqind (5%) të të ardhurave të dedikuara të Agjencisë (ku përfshihen pagat e nëpunësve të AKP-së), Bordi, me datë 07.10.2021 kishte miratuar buxhetin për vitin 2022, duke përcaktuar shkurtimet buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në masën prej 30%.

Andaj, për sa me sipër Kolegji i Këshillit konstaton se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me rastin e nxjerrjes se Vendimit me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 për miratimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-023, Ligjin Nr.05/L-080, dhe Ligjin Nr.04/L-115).

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1170/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në AKP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

